



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008”, neneve 15, 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, e në mbështetje të nenit 9, paragrafi 1, pika 7, të Udhëzimit Administrativ, Nr-27/20112, të nxjerr nga MPB-ja dhe Nr-03/2012, të nxjerr nga MAPL-ja me datën 22.08.2012, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën,-----, miratoi këtë:

## **Projekt-V E N D I M**

### **Neni 1**

Me këtë vendim miratohet plani vjetor i punës për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për periudhën janar-dhjetor për vitin 2023.

### **Neni 2**

Pjesë përbërse e këtij vendimi është plani i veprimit për këshillin komunal për siguri në bashkësi për periudhën janar-dhjetor 2023, i hartuar nga Koordinatorin i këshillit komunal për siguri në bashkësi në bashkpunim me anëtarët e këshillit komunal për siguri në bashkësi dhe i miratuar nga Kuvendi i Komunës në Suharekë.

### **Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës njëherit Kryesues i këshillit komunal për siguri ne bashkësi dhe Koordinatori i këshillit komunal për siguri ne bashkësi.

### **Neni 4**

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

## **KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË**

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Mr.ec Bexhet KUÇI**

01-Nr-\_\_\_\_\_

Me datë\_\_\_\_\_